



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZL.Anr.185/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Koalicioni Vakati, me seli në Pejë, paraqitur kundër Narodna Demokratska Stranka (NDS), me seli në Pejë për shkak të kërcënimeve, për Zgjedhjet Lokal 2017, e që do të mbahen më 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.185/2017 e datës 11.10.2017 e subjektit politik Koalicioni Vakati, me seli në Pejë.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 11.10.2017 nga politik Koalicioni Vakati, me seli në Pejë. me të cilën pretendon se në mëngjesin e datës 06.10.2017 ka pranuar disa mesazhe kërcënuese, fyerje, sharje, me nofkat poshtëruese në adresën e Omer Daçiç.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një listë me mesazhe me të cilat pretendohet se është bërë veprimi i ndaluar

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli me rastin e vlerësimit të paanshmërisë së ankesës ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për tu shqyrtuar nga ana e PZAP-it, pasi që parashtruesi i ankesës paraprakisht është dashur ti drejtohet organeve të ndjekjes lidhur me rastin.

Mbi këtë bazë Paneli nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve ankimore të parashtruesit të ankesës përkitazi me kërcënimet e bëra në adresën e tij, për faktin se, e drejta për paraqitjen e ankesës është e kufizuar në bazë të dispozitës së nenit 115.1 të LPZ-së, ku përcaktohet: *“PZAP është organ i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me ligj dhe rregullat zgjedhore”* dhe në rastin konkret shkelja e pretenduar nuk ka të bëjë me procesin zgjedhor.

Paneli në kuptim të nenit 6.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Rregullës nr. 02/2015) dhe nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 185/2017 më datën 12.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 18 par. 4 të LZP-

